

*eppc kërkon Arkitekt/e për Hapësirat e Brendshme në dyqan për klientin e saj, lider në Shqipëri dhe në tregun botëror në fushën e pllakave, hidrosanitareve, kuzhinave, sistemeve të ndërtimit dhe planifikimit të hapësirave të brendshme të banimit dhe tregtare.*

### Qëllimi kryesor i punës:

Arkitekti/ja do të ideojë dhe projektojë dizajne të hapësirave të brendshme banimi apo tregtare sipas nevojave të klientëve. Ai/ajo takohet me klientët për të kuptuar çfarë ata duan, cila është hapësira dhe si do të përdoret dhe sa buxhet kanë në dispozicion. Në bazë të tyre ai/ajo këshillon e informon klientin lidhur me faktorët që ndikojnë dizajnin, të tilla si, planifikimi i hapësirës, përdorimi i mobiljeve dhe pajisjeve, koodinimi i ngjyrave, aksesorët. Përgatit projektin duke zgjedhur materialet më të përshtatshme për dizajnin dhe buxhetin e klientit dhe bën një parashikim të kostos sipas cmimeve përkatëse. Prezanton projektin tek klienti dhe bën korigjimet e nevojshme në bazë të kërkesave të tij.

### Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Ekspierencë të mëparshme në ideimin dhe projektimin e hapësirave të brendshme;
- Kreativitet dhe imagjinatë;
- Të njohë dhe përdorë shumë mirë Autocad, Sketch UP, 3D max, Domus 3D;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të jetë konfident/e dhe me aftësi bindëse;
- Paraqitje profesionale dhe të jetë i/e orientuar drejt shërbimit të klientit;
- Përdorim shumë i mirë i paketës Microsoft Office dhe Internetit.

### Të dhënat:

Pozicioni:	Arkitekt/e e hapësirave të brendshme;
Vendndodhja:	Tiranë;
Orari:	Nga e Hëna në të Shtunë;
Raporton tek:	Manaxheri i shitjeve;
Udhëtime pune:	Jo;
Pagesa:	Në varësi të aftësive të kandidatit/es;
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	05.08.2013.

### Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke *përmendur pozicionin për të cilin aplikoni* në adresën e e-mail-it:

[recruitments@eppc.al](mailto:recruitments@eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.